



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.705/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Kymete Kicaj anëtare, duke vendosur përkitazi me ankesën e Egzona Bytyçi, kandidate për kuvend komunale nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Drenasit, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me objekt të çështjes keqpërdorim i votave ne vendvotim me nr. 0313E/01R, ne fshatin Arllat te Komunes se Drenasit, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa Anr.705/2021 e datës 21.10.2021, e paraqitur nga Egzona Bytyçi, kandidate për kuvend komunale nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Drenasit, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak keqpërdorimit të votave, ne vendvotim me nr. 0313E/01R, ne fshatin Arllat te Komunës se Drenasit, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 21.10.2021, ka pranuar një ankesë Anr.705/2021 nga Egzona Bytyçi kandidate për Kuvend Komunale nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Drenasit, në të cilën theksohet se, dyshimet e mija janë se janë keqpërdorur votat në qendrën e votimit në fshatin Arllat nuk më kanë dalë votat e prindërve në qendrën e votimit 0313E/01R.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë, për faktin se shkeljet që ndërliidhen me rezultatin

e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hedhja e ankesës së Egzona Bytyçit, kandidate për kuvend komunale nga Lëvizja Vetëvendosje, për komunën e Drenasit nuk e paragjykon çështjen dhe ankueses nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.705/2021 më datën 22.10.2021

Kryesuesi i Panelit



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*